



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1836 / Prot.

Tiranë, më 19.07 2023

V E N D I M

Nr. 54 datë 19.07 2023

**“PËR  
MIRATIMIN E REDUKTIMIT TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR CIKLIN E  
TRETË TË STUDIMEVE DOKTORATË NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË  
TIRANËS”**


Bazuar në Ligjin nr.80/2015“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH” pika 3/ç të nenit 3, të nenit 6 pika 28,29,30 të nenit 49, të nenit 77,78,79, në Statutin e UST, në Rregulloren e UST-së , në shkresën nr.90/2 datë 12.01.2023 “Kërkohet miratimi i kuotave për Ciklin e Tretë të studimeve në UST për vitin akademik 2022-2023”, në shkresë nr. 90/3, datë 18.01.2023 "Informacion mbi përcaktimin e udhëheqësve për programet e ciklit të tretë Doktoratë në UST për kuotat e vitit akademik 2022-2023", në vendimin e Senatit Akademik nr. 27, datë 16.02.2023 "Për miratimin e rregullores për organizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në UST", në shkresën e MAS nr. 2747 datë 27.04.2023 "Mbi kuotat e pranimit për vitin akademik 2023-2024", në vendimin e Senatit nr. 46 date 07. 04.2023 "Mbi miratimin e kuotave të pranimit, për vitin akademik 2023-2024 në UST", në Vendimin e BA nr. 32 datë 02. 05.2023 "Mbi miratimin e kuotave të pranimit, për vitin akademik 2023-2024 në UST" në shkresën e MAS nr. 203/2, datë 30 .06.2023 “Mbi listën e udhëheqësve shkencorë në programet e studimit të Ciklit të Tretë Doktoratë për vitin 2022-2023 ”, Vendim Senati Akademik nr.77 datë 14.07.2023 “Për miratimin e reduktimit të tarifës së shkollimit, për Ciklin e Tretë të studimeve Doktoratë në Universitetin e Sporteve të Tiranës” në mbledhjen e tij të datës 14 .07.2023,

**VENDOSI:**

1. Tarifat e aplikimit për aplikantët (FSHL,FVFR) dhe tarifat e regjistrimit të fituesve ( FSHL,FVFR) për ciklin e tretë të studimit Doktoratë , në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2022-2023, të jetë sipas Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 22 datë 26-04-2022;
2. Të miratojë tarifën e shkollimit për studentët që do të ndjekin studimet në ciklin e tretë të studimit doktoratë për të dy fakultetet sipas tabelës bashkëngjitur;
3. Tarifa e shkollimit për ciklin e tretë do të paguhet me këste;

4. Tarifa vjetore e shkollimit për ciklin e tretë Doktoratë të bëhet publike në faqen zyrtare të Universitetit [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al);
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, FSHL, FVFR, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, Drejtorja e Programeve të Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, Drejtorja e Marrëdhënive me Jashtë, Publikun dhe Studentëve.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek transparenca universitare .

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**



## FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

Tab. 1

Emertimi I Programit cikli I trete te studimeve Doktorate	Tarifa e shkollimit ( per kandidatet nga stafi efektiv ) në lekë	Tarifa e shkollimit per te tjere, ne leke
Shkenca Sportive (FSSL)	400 000	800 000

Tab. 2

## FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT

Emertimi I Programit cikli I trete te studimeve Doktorate	Tarifa e shkollimit ( per kandidatet nga stafi efektiv ) në lekë	Tarifa e shkollimit per te tjere, ne leke
Aktivitet Fizik dhe Shëndeti (FVFR)	400 000	800 000